



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni vjeshtor**

Kryesia e Kuvendit  
P-036  
Prishtinë, më 14.10.2008, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT ME KRYETARËT E GRUPEVE  
PARLAMENTARE, TË MBAJTUR MË 14 TETOR 2008**

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci, Naim Maloku, Xhezair Murati dhe Slllobodan Petroviq.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Lutfi Haziri, Lulzim Zeneli dhe Ardian Gjini.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Skënder Reçica dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Ismet Hajrullahu;

Nga NDI: Avni Zuka dhe

Nga OSBE: Petrit Hysaj.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi edhe dy pika shtesë.

Kryesia, me propozim të Kryetarit, miratoi këtë

#### **R e n d d i t e:**

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur 7 tetor 2008,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave, dhe
4. Të ndryshme.

#### **1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 7 tetor 2008**

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 7 tetor 2008, u miratua pa vërejtje.

#### **2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës**

**Kryetari** i njoftoi anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare me materialet e përgatitura për seancën e radhës.

**Kryesia**, me propozim të Kryetarit, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që më 17 tetor 2008 të mbahen dy seanca plenare.

Seanca solemne të mbahet më **17 tetor 2008, në orën 11:00**, me këtë

#### **R e n d d i t e:**

1. Miratimi i Rezolutës për deklaratën e Mijëvjeçarit.

Seanca e rregullt plenare të mbahet më **17 tetor 2008, në orën 12:30**, me këtë

#### **R e n d i i d i t ë s**

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Masat antidamping,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për akreditim,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbështetje ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nr. 02/L-5,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Noterinë,
8. Miratimi i Rekomandimeve të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjdis dhe Planifikim Hapësinor,

9. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës,
10. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për shqyrtimin e Raportit të Grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 02/L-74 për revizionin e brendshëm,
11. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për zbritjen e tarifës menaxhuese,
12. Njoftimi i grupeve parlamentare të LDK-së dhe të AKR-së për ndërrimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare.

### **3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave**

- 3.1 Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë së Kosovës për caktimin e datës së mbajtjes së regjistrimit të popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave

Me kërkesë të Qeverisë së Kosovës, kjo pikë shtyhet.

- 3.2 Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë së Kosovës lidhur me fillimin e procedurave të privatizimit të distribuimit dhe të furnizimit të KEK-ut,

**Kryesia**, pasi shqyrtoi rekomandimin e Komisionit, nxori këtë

#### **P Ë R F U N D I M**

Kërkohej nga Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion që ta shqyrtojë Vendimin e Qeverisë së Kosovës për fillimin e procedurave për privatizimin e Kompanisë për Furnizim dhe Distribuim me Energji Elektrike dhe Kuvendit t'ia paraqesë rekomandimin lidhur me të.

- 3.3 Shqyrtimi i Planit për implementimin e rekomandimeve në Raportin final të auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2007 për Kuvendin e Kosovës

**Kryesia**, pasi shqyrtoi Planin për implementimin e rekomandimeve, nxori këtë

#### **P Ë R F U N D I M**

Plani për implementimin e rekomandimeve në Raportin final të auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2007 për Kuvendin e Kosovës, t'u shpërndahet të gjithë deputetëve.

- 3.4 Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri lidhur me situatën e sigurisë në Kosovë.

Me propozimin e Kryetarit, kjo pikë shtyhet. Qeveria e Kosovës duhet t'i raportojë Kuvendit për gjendjen e sigurisë në vend.

### 3.7 Shqyrtimi i kërkesave për lejimin e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit

Kryesia shqyrtoi kërkesat për lejimin e udhëtimeve jashtë vendit dhe vendosi, si vijon: kryetarëve të grupeve parlamentare u lejohet udhëtimi zyrtar në Portugali, prej 26 deri më 29 tetor 2008, si dhe deputetes Drita Kadriu i lejohet udhëtimi zyrtar, në Itali, prej 12 deri më 15 nëntor 2008.

### 4. Të ndryshme:

4.1 Kryesia u njoftua me kërkesën e Grupit Parlamentar të AKR- së dhe të Grupit Parlamentar të LDK-së për ndërrimin e anëtarëve në komisionet parlamentare, të cilat duhet të procedohen në seancë plenare, si dhe me raportin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural nga vizita që kishte realizuar në Kroaci.

**Kryetari** e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit  
**Jakup KRASNIQI**

---

Hartoi:

**Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**